REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 177/26 Dt. 24.04.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bazuar në ftesën e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kosovës, për lejimin e udhëtimi zyrtar të Nderim Kadrijaj, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për pjesëmarrje në Edicionin e 5-të të Panairit Ndërkombëtar "Ditët e Bujqësisë 2026", që do të zhvillohen nga data 28 prill 2026 deri me 30 prill 2026 në Lushnje të Republikës së Shqipërisë, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar, mbulimi i shpenzimeve të ushqimit, akomodimit, pagesa e mëditjeve, si dhe shpenzimet e paparashikuara për të lartcekurin, konform, akteve ligjore për udhëtimet zyrtare.

2. Për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar me makinë zyrtare të Komunës së Prizrenit.

3. Nisja (shkuarja) zyrtare bëhet me datë 27 prill 2026, ndërsa kthimi me 30 prill 2026.

4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës– pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

5. Obligohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurit,
- Arkivës së Kryetarit.